



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:269351

Datë: 29.10.2024

Numri i dokumentit: 06367608

C-IV.-14-6703

Ankuesi:

B Q nga f.sh S e E K.Viti.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Agromorava”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt. 15 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI035-0186 i dt.02 tetor 2014.

2. OBLIGOHET e paditura AKP, që ankuesit B Q që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t’i paguaj shumën prej 1,200.00€, ndërsa, emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore t’i paguaj shumën prej 120.00 €.

3.Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

4.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.23 tetor 2014, ankuesi ish punëtor i NSH “Agromorava” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. GJI035-0186 i dt.02 tetor 2014 me të cilin ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,200.00€. Ankuesi pohoi se e kundërshton në tërësi vendimin e AL-së dhe ka shtuar se ka aplikuar në afat

ligjor kurse, marrëdhënia e punës i është ndërprerë me dt.25.11.2005. Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur kopjen e librezës së punës dhe Kopjen e listës së përfituesve të 20%-it.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj lënde me dt.01 shkurt 2024 ka lëshuar një urdhër për ankuesin me anë të së cilit ka kërkuar që të paraqes prova shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore duke ia specifikuar secilën veç e veç. Ankuesi e ka pranuar urdhërin dhe me dt.06 shkurt 2024 dhe deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Me dt.23 prill 2024 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit, pasi që AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht e që objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit. Tutje ka theksuar se Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë për ta shfuqizuar sepse, ankuesi është dashur ta paraqes kërkesën brenda tri viteve në gjykatë apo në ndonjë autoritet tjetër kompetent. Në këtë mënyrë mbrojtja ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar. Bashkangjitur mbrojtjes e njëjta ka kopjen e vendimit të cilin e ka atakuar ankuesi, kopjen e formularit për likuidim, kopjen e letërnjoftimit të ankuesit, kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kopjen e librezës së punës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet në tërësi si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par. 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështetin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Gjykata gjeti se në bazë të njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës ankuesi ka ofruar shërbime për NSH-në deri me dt.25 nëntor 2005 kurse, në bazë të listës së përfituesve të 20%-it si dhe në bazë të librezës së punës i njëjti ka ofruar shërbime për NSH-në për 20 vite.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme: (dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t’i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;

Gjykata e aprovoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në lartësinë e shumës të cilën ankuesi kërkuar ndërsa, e paditura nuk e kishte kundërshtuar fare në mbrojtjen e saj. Andaj, duke qenë se lartësia e kërkesës së palës nuk ishte kontestuese në mes të palëve në procedurë, gjykata e morri si të besueshme dhe ia fali besimin.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit por, të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vjen në përfundim se ankuesi B Q, kishte ofruar shërbime pune për NSH –në deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas njoftimit për ndërprerje të dt. 25.11.2005, që vërtetohet edhe me librezën e punës e cila i është mbyllur po me të njëjtën datë Pra në kuptim të kësaj ankuesit i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën e aprovuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t’i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi taksën gjyqësore e ka paguar me dt.29.11.2023.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrahet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala